



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 2097 Prot

Vlorë, më 24 / 07 / 2017

VENDIM

Nr. 23, datë 20 / 07 / 2017

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROCEDURAVE PËR DHËNIEN E  
“TITUJVE VENDOR TË NDERIT“

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 20 / 07 / 2017 në zbatim të nenit 77, pika II të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“, Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë“, Ligjit Nr.112/2014 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë” si dhe të VKM- së Nr.861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënie e medaljeve dhe titujve vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI;

1. Të miratoj Rregulloren mbi procedurat e dhënies së “Titujve Vendor të Nderit”, bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari, Sekretari i Këshillit të Qarkut, Komisioni Këshillimor, Drejtori i Kabinetit si dhe Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve pranë Këshillit të Qarkut Vlorë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

Ervis MOCKA



Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me Nr. \_\_\_\_\_ Prot, datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2017.